



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 5.4.2023

Nr: 290

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATIT PËR KRYETAR TË BASHKISË TIRANË, TË PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË", Z. ERION VELIAJ, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot, më datë 5.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën me:

**KËRKUES:** Subjekti Zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" me shkronja nistore "PS"

**OBJEKTI:** Regjistrimi i z. Erion Veliaj, si kandidat për kryetar të Bashkisë Tiranë, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

**BAZA LIGJORE:** Nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, 67, 72, 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, udhëzimi nr. 1, datë 18.1.2023 "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore", vendimi nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

VËREJ:

Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Në mbështetje të neneve 67, pika 2, 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" ka depozituar në KQZ kërkesën për regjistrimin e z. Erion Veliaj, si kandidat për kryetar të bashkisë Tiranë.

Data 5.4.2023 Nr:290  
Ora:12:00



"Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e kandidatit për kryetar të bashkisë Tiranë, të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", z. Erion Veliaj, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

Në mbështetje të nenit 67, pika 2, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetar apo për këshillin e bashkisë Tiranë, pasi Bashkia Tiranë administrohet nga më shumë se një KZAZ.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë listuar:

- Kërkesë për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, Model KQZ-04-06,
- Deklaratë e kandidatit për hapje llogarie bankare të posaçme, Model KQZ-04-08,
- Deklaratë për pranimin e kandidimit, Model KQZ-04-09,
- Jetëshkrimi i kandidatit, Model KQZ-04-10,
- Kopjen e dokumentit të identifikimit të kandidatit për kryetar bashkie,
- Formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar bashkie,
- Procesverbal i dorëzimit të dokumentacionit të kandidimit, Model KQZ-00-31.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, KQZ verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit të kandidatit për kryetar bashkie. Nga verifikimi i të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, kandidati për kryetar bashkie z. Erion Veliq, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, nuk është në kushtet e ndalimit parashikuar nga neni 2, i ligjit nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 73, pika 1, të Kodit Zgjedhor, në mbledhjen e datës 5.4.2023, verifikoi dokumentacionin e kandidimit të z. Erion Veliq, të depozituar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, dhe vlerëson se është në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 72, 73, të Kodit Zgjedhor.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72, 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore” dhe vendimin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

### **V E N D O S:**

1. Regjistrimin e z. Erion Veliq, si kandidat për kryetar në Bashkinë Tiranë, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Data: 5.4.2023 Nr: 290  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e kandidatit për kryetar të bashkisë Tiranë, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, z. Erion Veliq, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 5.4.2023 Nr: 290  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e kandidatit për kryetar të bashkisë Tiranë, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, z. Erion Veliaj, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”